



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2023:243375  
Datë: 11.03.2024  
Numri i dokumentit: 05434574

**C.nr.3833/2023**

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN- **Departamenti i përgjithshëm - Divizioni Civil**, me gjyqtarin Baki Shigjeqi, duke vendosur në çështjen juridiko- kontestimore të paditësit N.L. me numër personal ..... me vendbanim në fshatin .... komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson av. E.H. nga Prizreni, kundër të paditurve N.K. ish nga fshati .... Komuna e Gjakovës, L.K. me numër personal ....., me vendbanim në Gjakovë, të cilin me autorizim e përfaqëson av. B.O. nga Prishtina, Z.K. me numër personal ..... ish nga fshati .... Komuna e Gjakovës, M.K. me numër personal ..... me vendbanim në fshati .... Komuna e Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson av. B.O. nga Prishtina, M.S. nga fshati ..... Komuna e Prizrenit, Xh.Sh. nga fshati ..... Komuna e Prizrenit dhe “K.H.”, Sh.P.K me seli në Gjakovë, për shkake të vërtetimit të së drejtës së pronësisë dhe anulimi i kontratave, vlera e kontesti 3.500,00 euro, jashtë seance më datë **11.03.2024**, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. NDËRPRITET** procedura në këtë çështje juridike kontestimore për shkak të vdekjes së të paditurve N.K. dhe Z.K. që të dy ish nga fshati .... Komuna e Gjakovës.
- II.** Procedura e ndërprerë eventualisht do të vazhdoj kur trashëgimtarët e të paditurit të marrin përsipër procedurën, apo kur të njëjtit i thërret Gjykata që ta bëjnë këtë me propozimin e palës kundërshtare.

**A r s y e t i m**

Paditësi-propozuesi N.L. nga fshati ..... Komuna e Prizrenit, nëpërmjet të autorizuarës së tij, pranë kësaj gjykate me datë 10.11.2023 ka iniciuar padi kundër të paditurve-kundërpropozuesve N.K. ish nga fshati ..... Komuna e Gjakovës dhe L.K. nga Gjakovë, për shkake të vërtetimit të së drejtës së pronësisë dhe anulimi i kontratave, me propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, vlera e kontesti 3.500,00 euro.

Gjykata për zhvillimin e mëtutjeshëm të kësaj procedure kontestimore, me datë 13.11.2023, ka marrë aktvendim për përgjigje në padi dhe në kuptim të nenin 305 par.2 të LPK-së, ju ka

dërguar të paditurve-kundërpropozuesve njoftimin lidhur me propozimin për masën e sigurisë. Me datë 29.11.2023 të paditurit-kundërpropozuesit përmes të autorizuarit të tyre, kanë paraqitur përgjigjes në padi me të cilën e kanë kundërshtuar në tersi padinë e paditësit, duke i propozuar gjykatës që ta refuzoj në tersi padinë e paditësit dhe propozimin e paditësit-propozuesit për caktimin e masës së sigurisë ose i njëjti të hudhet poshtë si i pa lejuar.

E autorizuar e paditësit me parashtresën e datës 18.12.2023 e ka zgjeruar padie edhe ndaj të paditurve Z.K. ish nga fshati ..... Komuna e Gjakovës dhe M.K. me vendbanim në fshati .... Komuna e Prizreni, për shkake të vërtetimit të së drejtës së pronësisë dhe anulimi i kontratave, vlera e kontesti 3.500,00 euro.

Gjykata për zhvillimin e mëtutjeshëm të kësaj procedure kontestimore, me datë 12.01.2024 e kishte caktuar shqyrtimin gjyqësor lidhur me masën e sigurisë në këtë çështje kontestimore. Gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe atë me Aktvendimin me shenjë T.nr.175/2007 të datës 03.12.2007, të lëshuar nga Gjykata Komunale në Prizren, gjykata kishte konstatuar faktin e vdekjes së paditësit N.K. me datë 04.08.1984, ndërsa në seancën dëgjimore për masë të sigurisë, i autorizuari i të paditurit L.K. në deklarin e tij e ka njoftuar deklaruar se i padituri Z.K. ka ndërruar jetë me datë 23.06.2023, duke ia bashkangjitur edhe certifikatën e vdekjes me numër serik V 10642895 lëshuar nga Zyra e gjendjes civile në fshatin ..... komuna e Gjakovës, lëshuar me datë 21.11.2023.

E autorizuar e paditësit me parashtresën e datës 06.03.2024, përsëri e ka zgjeruar padie dhe propozimin për caktimin e masës së sigurisë në kuptimin subjektiv edhe ndaj të paditurve tjerë M.S. nga fshati .... Komuna e Prizrenit, Xh.Sh. nga fshati ..... Komuna e Prizrenit dhe “K. H.”, Sh.P.K me seli Gjakovë, dhe në kuptimin objektiv edhe ndaj ngastrave kadastrale me numër P-01574-4, P-01574-5 dhe P-01574-6 ZK, Zym, Komuna e Prizrenit. Paditësi edhe me parashtresën e datës 06.03.2024 për zgjerimin padisë, endi si palë të paditur e ka përfshirë të ndjerin Z.K. ish nga fshati ..... Komuna e Gjakovës.

Në bazë të Aktvendimin me shenjë T.nr.175/2007 të datës 03.12.2007, të lëshuar nga Gjykata Komunale në Prizren dhe certifikatës së vdekjes të lëshuar më datë 21.11.2023, nga Zyra e Gjendjes Civile në fshatin ..... Komuna e Gjakovës, me numër rendor 21 dhe numrin e referencës 20/2023RV/2011, kjo Gjykatë vërtetoi faktin se i paditurit N.K. i lindur me datë 28.12.1906 kishte ndërruar jetë me datën 04.08.1984, në fshatin Kushavec, Komuna e Gjakovës, ndërsa i padituri Z.K. i lindur me datë 23.05.1945 kishte ndërruar jetë me datën 23.06.1923, në fshatin Kushavec, Komuna e Gjakovës, andaj kjo çështje juridike kontestimore **NDËRPRITET**, për shkak të vdekjes së të paditurve të lartcekur.

Përkitazi me situatën juridike të krijuar, kur vdes një palë ndërgjyqëse, gjegjësisht kur vdes njëri nga të paditurit, si në rastin konkret, për këtë bëhet fjalë në nenin 277 të LPK-së, e në të cilin, thuhet se: *“Procesi gjyqësor ndërpritet: a) kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humb zotësinë procedurale, e nuk ka të caktuar përfaqësues me prokurë në gjykim ...”* kurse në nenin, 280 par.1 të LPK-së, është paraparë se : *“Procedura që është ndërprerë për shkaqe të treguara në nenin 277 paragrafi 1 pika a) deri te d) të këtij ligji, do të vazhdohet kur*

*trashëgimtari, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore ... e marrin përsipër procedurën apo kur i thërret gjykata ta bëjnë këtë, me propozimin e palës kundërshtare''.* Duke qenë se me parashtrësën e datës 18.12.2023 përkatësisht në seancën dëgjimore për masën e sigurisë të datës 12.01.2024, nga provat e prezantuar nga vetë palët ndërgjyqëse, gjykata është njoftuar për faktin e vdekjes së të paditurve N.K. dhe Z.K. dhe se sipas Aktvendimit mbi trashëgimin me shenjën T.nr.175/2007 të datës 03.12.2007, të lëshuar nga Gjykata Komunale në Prizren dhe certifikatës së vdekjes të lëshuar më datë 21.11.2023, nga Zyra e Gjendjes Civile në fshatin Bishtazhin, Komuna e Gjakovës, me numër rendor 21 dhe numrin e referencës 20/2023RV/2011, provohet të paditurit N.K. dhe Z.K. që të dy ish ish nga fshati Kushavec, Komuna e Gjakovës, kanë vdekur, andaj edhe për këtë arsye, kjo gjykatë konsideroj se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për ndërprerjen e procesit gjyqësor në këtë çështje juridike kontestimore, kurse i njëjti proces gjyqësor kontestimorë, do të vazhdoj kur trashëgimtarët e të paditurit N.K. gjegjësisht Z.K. apo kujdestari i pasurisë trashëgimore të tij, e marrin përsipër procedurën apo kur i thërret gjykata, t'a bëjnë këtë, e me propozimin e palës kundërshtare.

Andaj, duke marrë parasysh të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 277 pika (a) si dhe neni 280 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
**2023:243375, 11.03.2024**

**G j y q t a r i**

---

**Baki Shigjeqi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.